REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 336, Datë 06.11.2026

MBI

VIJIMIN E PROCEDURËS SË FILLUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 345, DATË 29.12.2025 "MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "VOLTON" SH.P.K. PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJES ME SHOQËRINË OSSH SH.A., LIDHUR ME PIKËN E MATJES "TONA ALB/6390"

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, gërma "d", të ligjit nr. 59/2026 *"Për sektorin e energjisë elektrike"*; neneve 53, pika 2, 87 dhe 88 të ligjit nr. 44/2015 *"Kodi i Procedurave Administrative*"; *Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 114, datë 08.07.2016; si dhe nenit 15 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.11.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 3475 prot., datë 04.11.2026, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve *"Mbi vijimin e procedurës së filluar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 345, datë 29.12.2025 "Mbi kërkesën e shoqërisë "VOLTON" sh.p.k. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë OSSH sh.a., lidhur me pikën e matjes "TONA ALB/6390",*

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 345, datë 29.12.2025, ka vendosur pranimin për shqyrtim të kërkesës së shoqërisë "VOLTON" sh.p.k., të protokolluar në ERE me nr. 2489 prot., datë 19.09.2025, dhe fillimin e procedurës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., lidhur me konfigurimin e gabuar të parametrave të matjes në pikën e matjes "TONA ALB/6390" dhe efektet financiare të pretenduara prej tij.
- Në zbatim të urdhrit nr. 12, datë 20.01.2026, është zhvilluar seanca dëgjimore e datës 28.01.2026, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shoqërive "VOLTON" sh.p.k. dhe OSSH sh.a. Në këtë seancë, OSSH sh.a. ka mbajtur qëndrimin se pasaktësia në parametrat e matjes ka qenë rezultat i një gabimi njerëzor gjatë konfigurimit të pajisjeve, se gabimi është korrigjuar dhe se, pas rillogaritjes së konsumit dhe faturimit sipas situatës reale, nuk lind detyrim shtesë për kompensim financiar ndaj furnizuesit.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 64, datë 26.02.2026, ka vendosur shtyrjen e vendimmarrjes dhe detyrimin e shoqërisë "VOLTON" sh.p.k. për të depozituar provë shkresore për pezullimin e gjykimit pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Shoqëria "VOLTON" sh.p.k. ka depozituar pranë gjykatës, më datë 02.03.2026, kërkesën për pezullimin e gjykimit dhe e ka paraqitur atë edhe pranë ERE-s, duke përmbushur detyrimin e vendosur.
- Në zbatim të urdhrit nr. 93, datë 27.04.2026, është zhvilluar seanca e dytë dëgjimore më datë 05.05.2026, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shoqërive "VOLTON" sh.p.k. dhe "Furnizuesi i Tregut të Lirë" (FTL) sh.a.. Përfaqësuesit e OSSH sh.a., ndonëse të njoftuar

rregullisht me shkresën nr. 58/10 prot., datë 27.04.2026, nuk u paraqitën në seancë dhe nuk paraqitën arsye për mosparaqitjen.

- Shoqëria "VOLTON" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 58/13 prot., datë 20.05.2026, ka depozituar pretendimet përfundimtare, me të cilat kërkon detyrimin e OSSH sh.a. për dëmshpërblimin e vlerës së energjisë elektrike të blerë, të hedhur në rrjet dhe të pafaturuar te klienti, për periudhën 01.03.2025 – 03.04.2025, në masën 938,55 MWh, si dhe të fitimit të munguar dhe dëmeve të tjera të pretenduara.
- ERE, me shkresën nr. 58/14 prot., datë 26.05.2026 dhe me shkresën e datës 04.08.2026, i ka përcjellë OSSH sh.a. pretendimet përfundimtare të shoqërisë "VOLTON" sh.p.k. dhe i ka kërkuar depozitimin e qëndrimit me shkrim brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja dijeni. OSSH sh.a. nuk ka depozituar asnjë qëndrim, shpjegim apo dokumentacion në përgjigje të këtyre kërkesave.
- Paraqitja e qëndrimit dhe e dokumentacionit nga OSSH sh.a. është e nevojshme jo vetëm për ushtrimin e së drejtës së saj për t'u dëgjuar, por edhe për të mundësuar një vendimmarrje të plotë dhe të arsyetuar nga bordi i ERE-s, në përputhje me parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe të drejtës së palëve për t'u njohur me provat dhe për t'u shprehur mbi to përpara marrjes së vendimit përfundimtar, sipas neneve 5, 12, 45, 87 dhe 88 të Kodit të Procedurave Administrative.
- Gjithashtu, me qëllim që vendimmarrja e bordit të ERE-s të bazohet në rrethana faktike të plota, vlerësohet që OSSH sh.a. të paraqesë: a) sqarimin e periudhës gjatë së cilës konfigurimi i gabuar i transformatorëve të rrymës në pikën e matjes "TONA ALB/6390" ka ndikuar në saktësinë e matjeve, si dhe dokumentacionin teknik që mbështet qëndrimin e mbajtur prej saj në seancën dëgjimore të datës 28.01.2026, lidhur me shkakun e këtij gabimi; b) provat që vërtetojnë pretendimin se ka korrigjuar matjet dhe faturat (faturat e korrigjuara/sistemuese të lëshuara për atë periudhë.
- Duke qenë se Kodi i Procedurave Administrative dhe aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të posaçëm, në kuptim të nenit 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 *"Kodi i Procedurave Administrative*", organi publik që zhvillon procedurën është kompetent të caktojë me vendim një afat procedural të arsyeshëm, në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes. Për rrjedhojë, vlerësohet e nevojshme caktimi për shoqërinë OSSH sh.a. të një afati përfundimtar prej 10 (dhjetë) ditësh pune nga njoftimi i vendimit, për depozitimin e qëndrimit të saj. Në rast mos depozitimi nga ana e OSSH sh.a. për sa kërkuar më sipër, ERE do të vijojë procedurën dhe do të vendosë mbi bazën e akteve dhe provave të administruara në dosje.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. të depozitojë pranë ERE-s, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga njoftimi i këtij vendimi, qëndrimin e tij me shkrim, të shoqëruar me çdo dokument mbështetës, lidhur me kërkesën e shoqërisë "VOLTON" sh.p.k., në kuadër të procedurës së filluar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 345, datë 29.12.2025.
   a) Sqarimin e periudhës gjatë së cilës konfigurimi i gabuar i transformatorëve të rrymës në pikën e matjes "TONA ALB/6390" ka ndikuar në saktësinë e matjeve, si dhe dokumentacionin teknik që mbështet qëndrimin e mbajtur prej saj në seancën dëgjimore të datës 28.01.2026, lidhur me shkakun e këtij gabimi;
   b) Dokumentacionin provues që vërteton pretendimin se ka korrigjuar matjet dhe faturat (faturat e korrigjuara/sistemuese të lëshuara për atë periudhë.

2. Në rast se OSSH sh.a. nuk depoziton qëndrimin e tij brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ERE vijon procedurën dhe bordi i ERE-s vendos mbi mosmarrëveshjen mbi bazën e akteve dhe provave të administruara në dosje.

3. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqëritë "VOLTON" sh.p.k. dhe OSSH sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI